

## Përkthim letrar

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti: Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
Titulli i lëndës:	Vepra të zgjedhura të letërsisë moderne
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i IV-të
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	5 ECTS
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. asoc. Dr. Albulena Blakaj- Gashi
Të dhënat kontaktuese:	Tel: 038222970/ albulena.blakaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda “Përkthim letrar” është lëndë e cila ka për qëllim të t’u ndihmojë studentëve të aftësohen në përkthimin e teksteve letrare nga gjermanishtja në shqip dhe anasjelltas. Kombinohet teoria me praktikën duke u marrë me përkthimin e formave epike, të autorëve të ndryshëm, kryesisht të shek 19. e 20. Tekstet, së pari lexohen, pastaj diskutohen e përkthehen. Studentët mësojnë paraprakisht çështjet themelore, të rëndësishme për përkthyesit, siç janë: hulumtimi paraprak, të punojnë me fjalorë dhe nga opcionet e shumta të dhëna në fjalor të zgjedhin fjalën e duhur, interneti dhe tekstet paralele. Mësohen të mos bartin rregullat gramatikore, morfologjike e sintaksore nga njëra gjuhë në tjetrën. Përveç kësaj përpunohen edhe strategjitë e përkthimit. Merren edhe tekste që tanimë janë përkthyer në shqip, një apo më shumë herë. Mësohen të krahasojnë përkthimet dhe të dallojnë një përkthim të suksesshem nga një jo i mirë.

## Qëllimet e lëndës:

- Kjo lëndë ka për qëllim t'u ofrojë studentëve njohuri për përkthimin si proces dhe dimensionet e tij.
- Ka për qëllim t'u ofrojë praktikë profesionale të përkthimit të teksteve të ndryshme letrare nga gjuha gjermane në atë shqipe dhe anasjelltas.
- Kjo lëndë ka për qëllim që përmes punës praktike t'i aftësojë studentët të përkthejnë tekste të fushës së letërsisë.
- Thellimi i njohurive gjuhësore që zbatohet në fusha specifike

## Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të sukseshem të këtij kursi (lënde) studenti do të:

- dijë për rëndësinë e përkthimit letrar si pasurim kulturor dhe urë lidhëse mes dy kulturash;
- Ta kuptojë përkthimin si proces të bartjes së kuptimit e jo të fjalëve të veçanta
- t'i identifikojë, t'i definojë dhe t'i verbalizojë problemet e procesit të përkthimit dhe të gjejë zgjidhje
- dijë të përdorë fjalorin dhe të zgjedhë fjalën e duhur gjatë përkthimit, si dhe të përkthejë drejt pa shumë gabime morfologjike e sintaksore dhe pa i bartur rregullat sintaksore nga njëra gjuhë në tjetrën
- të mund të përkthejë pa shumë mund tekste letrare të një vështirësie mesatre nga gjuha gjermane në atë shqipe dhe anasjelltas,
- dallojë një përkthim të suksesshëm nga një i dobët

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.5
Teori/Punë në laborator/Ushtime	-		
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	10min	15	2.5
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit			
Detyrë shtëpie	3	15	45
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	6	2	12
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	1	2
Projektet, prezantimet, etj.	1	4	4
<b>Total</b>			<b>118:25= 4.72 5 ECTS</b>

**Metodat e mësimdhënies:**

Gjatë një semestri me dy orë në javë punohet intenzivisht me tekste të zgjedhura letrare të cilat janë përkthyer nga studentët paraprakisht lexohen, diskutohen. Përkthehen tekste edhe gjatë orës dhe problemet e ndryshme që hasen me këtë rast, zgjidhen aty për aty. Punohet individualisht dhe pastaj në grup duke krahasuar përkthimet e njëri-tjetrit dhe duke u munduar të zgjedhin përkthimin e qëlluar. Punohet poashtu në grupe të cilat analizojnë dhe krahasojnë përkthimet e ndryshme të së njejtës vepër, p.sh. nga gjermanishtja në shqip apo edhe anasjelltas dhe diskutohet për dallimet dhe ngjajshmëritë, si dhe krahasohen me veprën në original.

<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%.  Vijueshmëria e studentit 10%;  Detyrat individuale të kryera në shtëpi 20%;  Provimi final 70%.</p> <p>Pasi që studentët gjatë tërë semestrit do të punojnë intenzivisht, ata edhe do të notohen për çdo punën: përkthimet, detyrat e shtëpisë që bëjnë, kurse në fund të semestrit mbahet provimi përfundimtar i cili është me shkrim.</p>
<b>Literatura primare:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Tekste të zgjedhura nga vepra të njohura të letërsisë moderne e bashkëkohore në gjuhën gjermane dhe shqipe, si dhe: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nord, C. 2003. Textanalyse und Übersetzen: theoretische Grundlagen, Methode und didaktische Anwendung einer übersetzungsrelevanten Textanalyse. Tübingen: Groos, cop.</li> <li>• Gentzler, E. 2001. Contemporary translation theories. Clevedon (etc.): Multilingual Matters.</li> <li>• Prunč, E. 2002. Einführung in die Translationswissenschaft. Institut für Translations-wissenschaft, Universität Graz.</li> </ul> </li> </ul>
<b>Literatura shitesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• “Übersetzer und Dolmetscher” Hrsg. Volker Kapp 1993: Francke Verlag, Tübingen und Basel 6.</li> <li>• Nord, C 1991: Einführung in das funktionale Übersetzen, Francke Verlag, Tübingen</li> <li>• Tupja, E 2000: <i>Keshilla nje perkthyesi te ri</i>, Onufri, Tiranë</li> </ul>

### Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Einführung in das Fach: Literarische Übersetzung
Java 2:	Grundregeln der Übersetzung
Java 3:	Übersetzung als Prozes; Übersetzung als Sprach- und Kulturmittlung
Java 4:	Literarische Übersetzung und desen Rolle für den interkulturellen Austausch
Java 5:	Übersetzung verschiedener Literarischer Formen
Java 6:	Die Übersetzung von Prosatexten
Java 7:	Die Übersetzung des Dramas
Java 8:	Die Übersetzung von lyrischen texten
Java 9:	Prosaübersetzung aus dem Deutschen

Java 10:	Prosaübersetzung aus dem Albanischen
Java 11:	Lyrikübersetzung aus dem Deutschen
Java 12:	Lyrikübersetzung aus dem Albanischen
Java 13:	Vergleich von Prosatexten aus dem deutschen übersetzten Werken
Java 14:	Vergleich von texten aus der deutschen übersetzten Lyrik
Java 15:	Wiederholung

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk tolerohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studentit i nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së.